



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT STRATEGJI

Nr. _____/2017

PËR

“PËR STRATEGJINË E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Përmbajtja

A. Analizë e Edukimit Ligjor të Publikut

- I. Hyrje
- II. Kuadri ligjor
- III. Prezantimi i gjendjes aktuale
- IV. Gjetjet dhe problematikat

B. Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

Objektivi 1. Organizimi i Rrjetit Kombëtar Shqiptar për Edukimin Ligjor të Publikut
Objektivi 2. Konkretisht, nga analiza e situatës aktuale vihet re nevoja e ndryshimeve ligjore për fuqizimin e mëtejshëm të ELP.

Përfundim: Hapat e Radhës

Shtojca I

Legjislacioni që do të ndryshohet

Shtojca II

Plan Veprimi

Shtojca III

Projekt Amendamente Për Ligjin Nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar”

A. ANALIZË E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT

I. Hyrje

Jeta jonë e përditshme zhvillohet dhe mbështetet nga rregulla ligjore që disiplinojnë sjelljen, veprimet dhe marrëdhëniet tona. Por, mjaft shtetas kanë njohuri të pamjaftueshme të ligjeve, që ndikojnë në jetën e tyre. Njohja dhe respektimi i ligjit nga qytetarët jo vetëm ndikojnë në jetën e tyre, por janë kushte të domosdoshme për mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e shtetit të së drejtës. Që qytetari të përfitojë nga garancitë dhe mundësitë që i njej ligji më parë duhet ta njohë atë dhe të kuptojë të drejtat që ai i jep. Qëllimi i kësaj projektstrategjie është pikërisht koordinimi i faktorëve institucionalë me qëllim një promovim dhe rritje të institucioneve shtetërore për edukimin ligjor të publikut.

II. Kuadri ligjor

- a) Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- b) Ligji Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”;
- c) Ligji Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin Nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”;
- d) Ligji nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar”;
- e) Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
- f) Ligj Nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- g) Ligji nr. 10.385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
- h) Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- i) Ligj nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar me ligjin nr.7920, datë 19.04.1995, ligjin nr. 8790 datë 10.05.2001, ligjin nr. 9216 datë 01.04.2004, ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, ligjin, nr. 10491 datë 15.12.2011, ligjin nr. 79/2013, datë 14.02.2013, ligjin nr. 131/2013, datë 29.04.2013;
- j) Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9795, datë 23. 07.2007, ligjin nr. 10 047, datë 24. 12.2008, si dhe ligjin nr. 91/2012, datë 27. 09. 2012;
- k) Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

II. Prezantimi i gjendjes aktuale

Publiku i gjerë në Shqipëri, ka nivel të pamjaftueshëm të njohurive bazë ligjore. Në mungesë të informacionit të shëndoshë, njerëzit ndikohen nga mitet dhe keqkuptimet nga ato që u prezantohet apo u shitet. Kjo ka ndikim negativ në respektimin e ligjit, në marrëdhëniet familjare, transaksionet e biznesit, në mbrojtjen publike të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit etj.

Ligji është kompleks dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Kjo është edhe më e vërtetë kur ligjet ndryshohen shpesh, saqë qytetarët dhe madje edhe profesionistët ligjorë mbeten mbrapa me njohuritë që kanë për ligjin e zbatueshëm për ta. Pjesa më e madhe e legjislacionit në fuqi është më pak se 25-vjeçare, pra, nuk ka një kulturë të trashëguar të vetëdijes ligjore. Shumë njerëz në Shqipëri shkojnë në gjykatë pa përfaqësim ligjor.

Niveli i ulët i njohurive mbi ligjin përbën pengesë për zhvillimin njerëzor dhe ekonomik në Shqipëri. Me aderimin në BE, ritmi i ndryshimit merr hov të ri dhe shoqëria shqiptare ka nevojë të përgatisë qytetarët të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të përshtatshme në një mjedis social dhe ekonomik të rregulluar me rregulla komplekse.

Për shkak të mungesës së dijes apo informacionit, qytetarët ndihen të distancuar nga institucionet dhe nuk ia dalin dot të ushtrojnë të drejtën e tyre të pjesëmarrjes demokratike. Qytetarët kanë nevojë të njohin ligjet e reja të miratuara në kuadër të Reformës në Drejtësi, me qëllim që të jenë të aftë të marrin pjesë aktivisht dhe të kenë akses në organet e reja të drejtësisë me qëllim përmbushjen e interesave të tyre legjitimë.

IV. Gjetjet dhe problematikat

Përfitimet e Edukimit Ligjor të Publikut

Njohja e ligjit e bën qytetarin më të mirë. Niveli i lartë i njohurive juridike është pozitiv për biznesin, mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit dhe marrëdhëniet familjare. Kjo i bën institucionet shtetërore në të gjitha nivelet e qeverisjes të punojnë më mirë, zvogëlon konfliktet dhe lehtëson zgjidhjen e konflikteve që mund të ndodhin, redukton barrën e gjykatave dhe përshpejton ecurinë e çështjeve etj.

ELP promovon *respektimin e ligjit*; kur njerëzit dinë rregullat themelore që rregullojnë aktivitetet e tyre të përditshme në marrëdhëniet familjare, punësimit dhe përgjegjësisë civile janë më të motivuar në respektimin e ligjit. Njerëzit duhet të dinë se çfarë është ligji, në mënyrë që t'i binden atij. Individët kanë nevojë për informacion të saktë që është i përshtatshëm për situatën e tyre, që të shmangin gabimet dhe konfliktet, si dhe që të manaxhojnë konfliktin me përgjegjësi kur ai lind.

ELP lehtëson *marrëdhëniet e qytetarit me administratën*; sepse qytetari kupton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore me të cilat ka të bëjë dhe e referon çështjen në organin përkatës. Qytetari arrin që aplikimet, kërkesat dhe ankesat t'i formulojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kështu që zyrtarët kuptojnë shpejt se cili është problemi edhe i japin zgjidhje brenda afateve ligjore të përcaktuara. Kjo është sidomos e rëndësishme në nivelin e bashkive, ku ndodhin shumica e kontakteve dhe ku preken të drejtat.

ELP përforcon *marrëdhëniet e biznesit me personat fizikë dhe juridikë*; kur njerëzit dhe shoqëritë hyjnë në transaksione me njëri-tjetrin, me ide të qartë për angazhimet, detyrimet dhe kushtet reciproke, si dhe duke njohur burimet dhe përgjegjësitë e tyre në rast mospërmbushjeje.

ELP ul mundësinë e *konflikteve ligjore*, sepse njerëzit kanë njohuritë themelore për të shmangur veprime që i ngarkojnë me përgjegjësi ligjore, mund të marrin masa paraprake ndaj shkeljeve të mundshme të të tjerëve, të kuptojnë kur përplasja e interesave përbën çështje ligjore dhe mund të negociojnë një zgjidhje me baza legjitime. Njerëzit e dinë kur duhet të marrin avokat dhe kur të kërkojnë ndihmë juridike, sepse i kanë të qarta faktet dhe çfarë kërkojnë. Kjo është e rëndësishme edhe për shumë njerëz që nuk kanë akses efektiv në shërbime profesionale ligjore

Niveli i lartë i njohurive juridike i bën gjykatat më efikase. Individët, sidomos ata që janë të papërfaqësuar, nuk çojnë në gjykatë çështje pa problematikë gjyqësore, por i drejtohen

gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshje ligjore; ata arrijnë të dallojnë kategoritë ligjore të detyrimeve, të mbledhin provat përkatëse dhe të shtrojnë argumente të përshtatshme e të bazuara në ligj. Numri i çështjeve në gjykatat administrative reduktohet kur zyrtarët ndërveprojnë me qytetarët mbi bazën e njohurive të shëndosha mbi ligjin.

Puna e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut bëhet më efektive kur njerëzit e dinë se si dhe kur të referojnë çështjet te ta.

Kur qytetarët e informuar ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në funksionimin e strukturave kushtetuese, kohezioni social dhe demokracia forcohen, dhe fuqia e vetinteresuar e elitave zvogëlohet.

Njohuritë juridike

Çdo i rritur duhet të dijë bazat e përgjegjësisë penale, përgjegjësisë civile, kontratave dhe të drejtës familjare. Të gjithë duhet të kenë akses të lehtë në informacionin bazë për legjislacionin mbi pronat dhe mbi qiramarrjen. Grupi i Punës beson se të gjithë qytetarët duhet të dinë rolet themelore të institucioneve kushtetuese, si dhe si të marrin pjesë në funksionimin e tyre. Ata duhet të kuptojnë në çfarë situatash është e përshtatshme t'i drejtohen gjykatës.

PLE synon t'i sigurojë njerëzve njohuritë për t'u përballur me problemet ligjore që mund të lindin, si edhe të informojë ata për hapat që duhet të ndjekin kur përballen me një problem të veçantë, të ndihmojë njerëzit të trajtojnë vetë problemet ligjore, si dhe të vendosin se kur u duhet përfaqësim profesional për të cilin kërkojnë një avokat.

Në fund të fundit, PLE ndihmon qytetarët të identifikojnë ligjet që duhet të ndryshojnë, si dhe të marrin pjesë në reformat e nevojshme dhe në rinovimin e shoqërisë së tyre. Botëkuptimi i gjerë i zbatimit praktik të shtetit të së drejtës rezulton në qytetarë më të angazhuar dhe në forcim të demokracisë kushtetuese.

Edukimi Formal dhe Ndërgjegjësimi Publik

Shkollat kanë mandate të veçanta institucionale për t'iu mësuar edukatën qytetare fëmijëve. Çdo strategji duhet të koordinohet me kurrikulën e institucioneve të edukimit formal. Shkollat profesionale dhe universitetet ofrojnë lëndët ligjore thelbësore për çdo profesion. Fakultetet e juridikut, Shkolla e Avokatisë dhe Shkolla e Magjistraturës mësojnë profesionistët e ligjit. Këto mund të luajnë rol në ELP.

B. STRATEGJIA PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT

Objektivi 1

Organizimi i Rrjetit Kombëtar Shqiptar për Edukimin Ligjor të Publikut

Institucionet zyrtare dhe organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri do të bashkëpunojnë në një rrjet me qytetarët, me qëllim që të forcojnë ndërgjegjësimin publik për ligjin, të nxisin procedimet ligjore të sigura, pjesëmarrjen e qytetarëve në institucione, respektimin e ligjit, aksesin në drejtësi dhe kulturën e shtetit të së drejtës. Strategjia përcakton objektivat dhe përfitimet e edukimit ligjor të publikut (ELP), institucionet dhe organizatat me rolet dhe përgjegjësitë e tyre, një marrëveshje të thjeshtë për formim rrjeti, si edhe aktivitetet që duhet të përmbajë Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë.

Strategjia do të zbatohet nëpërmjet një rrjeti institucionesh dhe organizatash, roli i të cilave ka të bëjë me ndërgjegjësimin ligjor të publikut. Duke qenë se kapaciteti dhe përgjegjësitë për edukimin ligjor të publikut janë të shpërndara në mënyrë të gjerë dhe të pabarabartë, kjo është mënyrë efiçente dhe e zhdërvjelltë për të përfshirë pikat e shumta të përgjegjësisë të cilat kanë rol në edukimin ligjor të publikut. Më konkretisht:

- Në qendër të rrjetit duhet të ketë organe të thjeshta koordinuese. Nuk ka nevojë që këto organe të punojnë me kohë të plotë dhe nuk propozohet të kërkohej financim publik për sekretariat të dedikuar. Organet drejtuese të rrjetit do të jenë *Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor*. Rrjeti duhet të ndërtohet me një rregullim të butë ligjor. Ky mund të jetë një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet organizatave pjesëmarrëse. Rrjete të ngjashme në vende të tjera janë të themeluara si organizata jofitimprurëse, dhe Grupi i Punës është i hapur ndaj propozimeve për instrumente të tjera normative. Do të ishte më mirë që Rrjeti të mos mbi-formalizohej, duke pasur parasysh se shumë prej organizatave pjesëmarrëse, në mos shumica prej tyre, nuk e kanë ELP në thelb të mandatit të tyre me ligj, dhe se shumë prej tyre janë vullnetare. GP ka kryer kërkime krahasuese, dhe nuk dimë për ndonjë vend ku të ketë një Ligj nga Parlamenti për Edukimin Ligjor të Publikut.
- Komisioni Drejtues do të menaxhojë punën e Rrjetit. Komisioni do të përbëhet nga përfaqësues të:
 - o Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - o Ministrisë së Drejtësisë;
 - o Ministrisë së Arsimit;
 - o Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - o Kuvendit;
 - o Avokatit të Popullit;
 - o Universiteteve;
 - o Shoqërisë Civile.
- Këta përfaqësues do të shërbejnë edhe si pika kontakti për institucionet e tyre; prandaj ata duhet të kenë akses në nivelet më të larta vendimmarrëse brenda institucioneve të tyre për të siguruar njehsim të punës në secilin institucion.
- Komisioni Drejtues do të jetë organ kolegjal dhe do të zgjedhë Kryetarin e tij. Kjo përfaqëje konsensuale i përshtatet një komisioni prej të barabartësh dhe parapëlqehet

për caktimin e kryesisë së një institucioni, në një fushë ku shumë pjesëmarrës janë vullnetarë. Kryetari organizon takimet sipas nevojës.

- **Bordi Këshillimor**, i cili përbëhet nga zyrtarë të lartë të të njëjtave institucione, bashkive, Dhomës së Avokatisë dhe Dhomës së Noterëve, ofron mbikëqyrje të politikave. Bordi mblidhet çdo tre muaj që të marrë raportin e Komisionit Drejtues, që të miratojë planet dhe që të japë udhëzime të përgjithshme për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë.
- **Anëtarët e Rrjetit** do të kenë lidhje elektronike me njëri-tjetrin. Rrjeti do të ketë një faqe në internet ku publikon punën e vet në mënyrë të përditësuar. Ai do të ketë një rezervë burimesh njerëzore dhe burimesh të tjera, profesionistë që ofrojnë shërbime vullnetare, burime ndërkombëtare, dokumente dhe mjete për rritjen e kapaciteteve dhe programimin.
- **Financimi**. Rrjete të ngjashme në vende të tjera marrin donacione dhe grante vullnetare nga individë, organizata, institute dhe agjenci financimi, përfshirë këtu agjencitë qeveritare. Ato përfitojnë nga kontributet vullnetare dhe në natyrë, të tilla si kohë dhe pajisje nga individë të përkushtuar, si edhe nga institucione dhe nëpunësit e tyre.
- **Institucionet**. Rrjeti do të lidhë persona dhe institucione që kanë aftësinë të ofrojnë edukim ligjor me institucione që kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetet për të informuar qytetarët dhe me organizata të shoqërisë civile të cilat ofrojnë shërbime në lidhje me njohuritë ligjore. Secili institucion publik luan rol në edukimin dhe informimin e publikut. Për zbatimin e Strategjisë, fillimisht Grupi i Punës, Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor, pasi të konstituohen, kërkojnë angazhimin e institucioneve dhe punojnë me to për të evidentuar nevojat për rritjen e kapaciteteve dhe për të siguruar burimet e nevojshme njerëzore dhe të informacionit, me qëllim që të përmbushin përgjegjësitë për të cilat bien dakord. Për shembull, kur Komisioni Drejtues propozon se një bashki duhet të ketë një program për t'i ofruar qytetarëve informacione të posaçme, ai do të evidentojë gjithashtu OJQ-të, juristët dhe/ose profesorët të cilët do t'i ofrojnë ekspertizën e tyre bashkisë për të trajnuar dhe mbështetur zyrtarët e bashkisë që kanë përgjegjësi ndaj publikut.
- **Bashkitë**. Secila bashki duhet të ketë një program ndërgjegjësimi publik për të informuar qytetarët rreth shërbimeve të disponueshme, kërkesave për leje dhe forumeve për angazhim në vendimmarrjen vendore. Veprimtaritë përfshijnë praninë në programe vendore radiofonike për informimin e qytetarëve, printimin dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve që shpjegojnë shërbimet dhe rregullat dhe dhënien e përgjigjeve për qytetarët që vijnë në bashki. Sferat e ligjit janë: e drejta kushtetuese, e drejta e qeverisjes vendore, e drejta administrative, e drejta e pronës.
- **Presidenca**. Si kryetar i shtetit, Presidenti përkrah kushtetutshmërinë dhe angazhimin civil në jetën publike. Strategjia duhet të ketë mbështetjen e tij. Duke marrë pjesë në aktivitetet e institucioneve, gjykatat, bashkitë, etj., ai ndërgjegjëson qytetarët rreth rolit dhe rëndësisë së institucioneve.
- **Kuvendi**. Roli i Kuvendit në edukimin ligjor të publikut është vazhdim i një angazhimi të rritur që ai ka ndërmarrë me qytetarët. Duhet të vihet në zbatim platforma ligjore e ofruar tashmë nga Ligji për Njoftim dhe Konsultim Publik për t'u ofruar qytetarëve të interesuar informacione në kohë reale mbi hapat e shpejtë të zhvillimeve dhe ndryshime legjislative në Kuvend. Ky i fundit ka një faqe interneti, si dhe një faqe dedikuar Reformës në Drejtësi e cila mund të shërbejë si një vend publikimi për nismat informuese. Në nivel lokal, zyrat e reja të anëtarëve të Kuvendit ofrojnë mundësi për ndërveprim të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Përveç kësaj, Kuvendi mund të ketë edhe një program sistematik vizitash; të

organizuara nga shkollat, vizitat e nxënësve në parlament duhet të jenë pjesë e konsoliduar e kurrikulumit të edukimit qytetar. Kuvendi duhet t'u ofrojë atyre ture të organizuara dhe prezantime për funksionimin e tij.

- *Gjyqësori.* Gjykatat e të gjitha niveleve duhet t'u japin qytetarëve informacion bazë mbi rolin e gjyqësorit; palët në gjykim duhet të marrin që në fillim informacion dhe udhëzime. Rrjeti i juristëve duhet të mobilizojë ndihmën për institucionet e gjyqësorit për hartimin e materialeve *online* dhe në letër që gjykatat t'i përdorin ato në fushatat për informimin e publikut dhe palëve në gjykim, sidomos të palëve të papërfaqësuar sa duhet. Gjykatat duhet të organizojnë rregullisht ditë të hapura në gjykatë, ku qytetarët të nxiten të vizitojnë gjykatat dhe të familjarizohen me institucionet e tyre parësore të rrugëzgjdhjes ligjore.
- *Institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut.* Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Avokati i Popullit, Komisioneri për Anti-Diskriminimin dhe të tjerët luajnë rol kryesor në hartimin e strategjive dhe materialeve për të drejtat e qytetarëve dhe për mënyrat e zbatimit të tyre. Ata shfaqen në media me qëllim edukues dhe botojnë dokumente informuese *online* dhe në letër.
- *Dhoma Kombëtare e Avokatisë.* Qëllimi kryesor i profesionit të juristit është që t'i shërbejë drejtësisë dhe interesit publik. Juristët në të gjitha fushat ku e zbatojnë profesionin e tyre kanë një rol për të luajtur në edukimin e publikut. Ata kanë një interes të drejtpërdrejtë në kërkesën e njerëzve për këshilla ligjore kur lidhin kontrata apo kur hyjnë në marrëdhënie biznesi, si dhe në nevojën e njerëzve për t'iu drejtuar rrugëve ligjore për zgjidhjen e problemeve të tyre. Qytetarët e edukuar janë klientët më të mirë. Daljet publike dhe puna *pro bono* me OJF-të përbëjnë praktika të mira profesionale për mbajtjen e lidhjeve të forta të juristëve individualë me rrjetin e juristëve të tjerë, si dhe e ngrenë profilin dhe reputacionin e këtij profesioni. Juristët që punojnë për administratën publike kanë një interes të fortë në pasjen e zyrtarëve të edukuar mbi ligjin në postet e menaxhimit publik për një zbatim më të mirë të ligjit dhe për të mos pasur gabime dhe konflikte, për të ulur rastet e zbatimit të gabuar të ligjit, padrejtësitë ndaj qytetarëve dhe numrin e çështjeve që përfundojnë në gjykatën administrative; një standard më i lartë ligjshmërie në administrimin e përditshëm do të thotë më pak punë për juristët e qeverisë.
- *Media.* Media publike e të gjitha llojeve është prej kohësh shpërndarësja kryesore e informacioneve ligjore publike, kështu që është e domosdoshme për Strategjinë. Organet e medias informojnë dhe argëtojnë; ato mund edhe të edukojnë. Ato duhet të kërkojnë mundësi për t'a zgjeruar ndërgjegjësimin ligjor të publikut, duke ofruar në transmetim ekspertizë dhe analiza.
- *Institucionet arsimore.* Fakultetet juridike nuk kufizohen me formimin e juristëve të ardhshëm. Ato, si dhe Shkolla e Magjistraturës dhe institucione të tjera arsimore mund të organizojnë aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuere të publikut në ambientet e tyre ose të marrin pjesë në aktivitete të tjera publike. Ata mund edhe t'i angazhojnë studentët në shërbime ligjore publike si pjesë të kurrikulumit të tyre arsimor.
- *Shoqëria civile.* Shërbimet e ndihmës ligjore kanë ofruar gjithmonë informacion ligjor si pjesë të punës së tyre për të siguruar akses në drejtësi. Organizatat e të drejtave të njeriut dhe grupet e advokacisë duhet të luajnë një rol në komunikimin me një publik të gjerë dhe në mobilizimin e angazhimit për marrje të njohurive ligjore. Ato përfshihen në advokacinë për akses në drejtësi dhe në reformën ligjore.
- *Aktivitetet e Edukimit Ligjor të Publikut.* Anëtarët e rrjetit, veçanërisht institucionet kushtetuese, do të angazhohen në një sërë aktiviteteve sistematike edukative dhe informative.

- *Aktivitetet e drejtpërdrejta në terren* janë të rëndësishme për marrëdhëniet midis qytetarëve, përfaqësuesve të zgjedhur dhe institucioneve të tyre. Këto përfshihen takime ku deputetët dhe të zgjedhurit e tjerë bisedojnë me qytetarët, dëgjesa të bashkisë me qytetarët për tema me rëndësi publike, fjalime publike dhe praninë në evenimente të veçanta dhe në raste të rëndësishme. Institucionet duhet të organizojnë rregullisht ditë të hapura, ku qytetarët ftohen të vizitojnë dhe të bisedojnë me zyrtarë të zgjedhur, gjyqtarë dhe stafin. Klasat e nxënësve të niveleve të ndryshme mund të organizojnë vizita në Kuvend, gjykata, këshilla bashkiakë, etj.
- *Aktivitetet e transmetuara* përfshijnë praninë e figurave publike në emisione televizive ku diskutohet mbi çështjet aktuale. Radiot dhe televizionet mund të prodhojnë një seri programesh që i përgjigjen pyetjeve të zakonshme rreth ligjit: nuk ka nevojë të kenë figura të famshme; mund të jenë të formave të ndryshme: emisione me panel, me telefonata, diskutime të informuara juridike duke përdorur si kontekst lajmet aktuale apo gjyqet famëkeqe. Teatri i aktualitetit, dramatizimi i problemeve ligjore që hasim në jetë dhe zgjidhjeve të tyre janë një mjet efektiv për të forcuar botëkuptimin e qytetarëve mbi rolin e ligjit në jetën e përditshme.
- *Faqja e internetit njoh ligjin.al* ofron informacion dhe udhëzim në fushat e ligjit që janë më të rëndësishme dhe më të vlefshme për qytetarët: marrëdhëniet e punës, ligji i familjes, procedura civile, etj. Ajo mund të jetë qendra e një fushate për informimin e publikut të gjerë për ligjin. Rrjeti e reklamon sa më shumë këtë burim. Gjithashtu, mund të zhvillohen ndërveprime *online* që i përgjigjen situatave specifike.
- *Dita Kombëtare e Ligjit* është një rast i përvitshëm që institucionet dhe organizatat të organizojnë aktivitete me përfshirjen e grupeve të ndryshme pjesëmarrëse. Evenimentet reklamohen për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe të pjesëmarrësve. Është e domosdoshme që aktivitetet të jenë *të hapura* ku qytetarët të drejtohen, sidomos në gjykata dhe në zyrat e baskisë për shërbime, me probleme dhe ankesa, për të bërë aplikime apo për të kërkuar zgjidhje. Institucionet organizohen që të ndihmojnë njerëzit që kanë njohuri të mangëta për të drejtat e tyre. Kjo është mëse e vërtetë për palët që nuk përfaqësohen në gjyq. Por, kur institucionet kanë organizimin e duhur, disiplinohet marrja e pyetjeve dhe ankesave dhe qytetarit i jepet informacioni kur i nevojitet.
- Formularët tip të dokumenteve ligjore mund të ndihmojnë ata që nuk kanë avokatë që të përfaqësojnë veten.

Objekti 2

Konkretisht, nga analiza e situatës aktuale vihet re nevoja e ndryshimeve ligjore për fuqizimin e mëtejshëm të ELP, si më poshtë:

- *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*. Në Ligjin për të Drejtën e Informimit, një prej objektivave të deklaruar është sigurimi i ndërgjegjësimit publik me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe lirive në praktikë, si edhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe qeverisë në shoqëri. Ligji kërkon prej autoriteteve publike të vënë në zbatim programe të transparencës institucionale për të identifikuar kategoritë e informacionit që duhet bërë publik, si dhe mënyrën e vënies në dispozicion të atij informacioni. Ligji duhet të ndryshohet për t'a zgjeruar dispozitën e transparencës në një detyrë për të informuar publikun mbi funksionimin dhe ligjin rregullues të autoritetit publik. Ai duhet të ndryshohet për të parashikuar rolin monitorues të përshkruar më lart. Gjithashtu, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të caktohet për të marrë

raportime në lidhje me veprimtari të edukimit ligjor të publikut të kryera nga autoritetet publike, si dhe të monitorojë përputhjen me detyrimet ligjore.

- *Institucionet Qeveritare.* Parimi i qeverisjes demokratike është që institucionet qeveritare nën Kushtetutën, pra Kuvendi, Qeveria dhe Gjyqësori, kanë përgjegjësinë e qenësishme, si pjesë e pozitës së tyre kushtetuese në një demokraci parlamentare, të përfshihen me qytetarët në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre sipas ligjit, si dhe në lidhje me rolet e këtyre institucioneve. Si pjesë e Reformës në Drejtësi, ligjet që po ndryshohen duhet t'a përfshijnë këtë parim; për shembull, ligji për qeverisjen e gjyqësorit duhet të bëjë të qartë shprehimisht se është përgjegjësia e Këshillit të Lartë të Drejtësisë t'a mbajë publikun të informuar për rolin dhe funksionimin e gjykatave dhe për aksesin në drejtësi.
- *Arsimi Parauniversitar.* Çdo qytetar duhet të përfundojë studimet e shkollës së mesme me njohuri bazë të parimeve të përgjithshme të ligjit që qeveris jetën e përditshme, përfshirë këtu:
 - Të drejtën penale;
 - Përgjegjësinë civile;
 - Marrëdhëniet Kontraktore;
 - Të drejtën e familjes.

Ligji për Arsimin Parauniversitar duhet të ndryshohet për t'i parashikuar këto pika, si përmbajtje të detyrueshme të edukimit mbi qytetarinë.

- *Administrata Publike.* Në ministri dhe agjenci të qeverisë, çdo nëpunës ka përgjegjësinë të informojë anëtarët e publikut në lidhje me bazën ligjore për
 - vendimet dhe veprimet që ndikojnë te qytetarët;
 - mandatin dhe funksionet e zyrës së tij/saj;
 - detyrimet e vendosura mbi qytetarët;
 - kushtet për lëshimin e urdhrave, lejeve, përfitimeve ose akteve të tjera që ndikojnë në interesat e secilit qytetar.

Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore duhet të ndryshohet për t'a bërë të qartë këtë detyrim.

- *Avokati i Popullit.* Ligji për Avokatin e Popullit duhet të ndryshohet për të parashikuar që Avokati i Popullit të publikojë informacion për t'i ndërgjegjësuar qytetarët në mënyrë efektive në lidhje me të drejtat dhe liritë që ky institucion mbron, rrethanat në të cilat ata mund të kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit, dhe procedurat për t'u ndjekur.
- *Ligji për Ndihmën Ligjore.* Ligji për Ndihmën Ligjore duhet të ndryshohet që të parashikojë Edukimin Ligjor të Publikut.
- *Media Publike.* Ligji për transmetuesin publik duhet të përfshijë një dispozitë për ELP. Nuk propozohet që kjo detyrë t'i ngarkohet kompanive private të transmetimit.
- *Institucionet e Pavarura të të Drejtave të Njeriut.* Ka disa institucione që kanë mandate ligjore në lidhje me edukimin ligjor të publikut. Kjo kërkon ndryshim në Statutet e themelimit të tyre, për t'a qartësuar këtë rol e për t'i dhënë një bazë juridike. Ligjit mund t'i shtohet një dispozitë që Avokati i Popullit të kryejë veprimtari të specifikuar të informimit publik në lidhje me të drejtat që mbrohen.
- *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.* Në mënyrë të ngjashme, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të parashikojë shprehimisht edukimin ligjor të publikut.
- *Ligjet Sektoriale.* Ka ligje që rregullojnë fusha të caktuara, ligje si ai për Inspektimin e Punës, të cilat parashikojnë edukimi ligjor. Duhet bërë një rishikim i tyre, nën mbikëqyrjen e forumeve të parashikuara në këtë Strategji, Bordi Këshillimor dhe Komisioni Drejtues, në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit.

Amendimet e mundshme ligjore

Legjislacioni shqiptar përmban dispozita të veçanta për edukimin ligjor të publikut, të shpërndara në një numër ligjesh të fushave të ndryshme. Grupi i punës rekomandon ndryshimin e ligjeve të identifikuara në Shtojcën I, për të zgjeruar disa prej këtyre dispozitave. Të marra së bashku, këto ndryshime do të përbëjnë bazën normative për një Strategji Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut, me një monitorim dhe koordinim sistematik.

Përfundime: Hapat e radhës

Hapat e radhës për të zbatuar këtë Strategji janë: Grupi i Punës thërret një takim të organizatave që të marrin pjesë në Rrjeti, që të konfirmohet marrëveshja në parim; si dhe konsultimi publik. Në mbledhjen e parë, Komisioni Drejtues mund të zgjedhë një Kryetar dhe të vendosë nëse organizatat pjesëmarrëse të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi.

SHTOJCA I

Ligjet që do të ndryshohen

Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
Ligji Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore”;
Ligji Nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin Nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”;
Ligji nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar”;
Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
Ligj Nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
Ligji nr. 10.385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
Ligj nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar me ligjin nr.7920, datë 19.04.1995, ligjin nr. 8790 datë 10.05.2001, ligjin nr. 9216 datë 01.04.2004, ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, ligjin, nr. 10491 datë 15.12.2011, ligjin nr. 79/2013, datë 14.02.2013, ligjin nr. 131/2013, datë 29.04.2013;
Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9795, datë 23. 07.2007, ligjin nr. 10 047, datë 24. 12.2008, si dhe ligjin nr. 91/2012, datë 27. 09. 2012;
Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

SHTOJCA II

Plani i Veprimit

Elementët e Planit të Veprimit

Një Plan Veprimi Kombëtar mund të hartohet dhe të zbatohet në përgjithësi si vijon:

1. Ngritja e Rrjetit
 - Grupi i Punës thërret në takim organizatave pjesëmarrëse
 - Organizatat identifikojnë pikat e tyre të kontaktit si përfaqësues në Komisionin Drejtues.
2. Mbledhja e parë e Komisionit Drejtues
 - Zgjedhja e Kryetarit
 - Përgatitja e Planit të Veprimit të hollësishëm
3. Mbledhja e parë e Bordit Këshillimor
 - Miratimi i Planit të Veprimit
4. Thirrje për pjesëmarrje vullnetare të universiteteve dhe OSHC-ve
5. Mbledhja e dytë e Komisionit Drejtues
 - Statusi ligjor dhe forma e organizimit
 - Identifikimi i listës së aktiviteteve
 - Identifikimi i aktorëve dhe roleve
 - Rendi i aktiviteteve
 - Plani i financimit

SHTOJCA III¹

Projekt Amendamente Për Ligjin Nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar”

Neni X

Edukimi ligjor i publikut është pjesë e ndihmës juridike dhe informacionit ligjor parësor siç përcaktohet në nenin 11 të këtij ligji.

Edukimi ligjor i publikut konsiston në ato veprimtari të ndërmarra nga institucionet publike dhe subjekte jo shtetërore, për të:

- Promovuar dije dhe zbatim të ligjit;
- Lehtësuar të kuptuarit e të drejtave dhe detyrimeve nga qytetarët;
- Lehtësuar ndërveprimin mes qytetarëve dhe administratës publike;
- Pakësuar rastet e konflikteve ligjore; dhe
- Rritur efikasitetin e gjykatave dhe organeve publike.

Neni X

Iniciativat dhe masat për edukimin ligjor të publikut do të zbatohen në përputhje me Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut (“Strategjia”) dhe Planin e Veprimit për zbatim të saj.

Strategjia do të zbatohet nga institucione publike të përcaktuara me akt nënligjor dhe subjekte jo shtetërore. Zbatimi i Strategjisë do të koordinohet nga një Komision Drejtues dhe një Bord Këshillimor, të përbërë nga përfaqësues të Institucioneve të Përcaktuara siç parashikohet në Strategji. Departamenti i Ndihmës Juridike mbikëqyr zbatimin e Strategjisë.

Institucionet përgjegjëse hartojnë një plan veprimi vjetor për Edukimin Ligjor të Publikut, zbatimin e veprimtarive mbi Edukimin Ligjor të Publikut në përputhje me planin e tyre vjetor, dhe alokimin e fondeve për këtë veprimtari.

Institucionet përgjegjëse përgatisin një raport vjetor mbi veprimtaritë e edukimit ligjor të publikut të zbatuara gjatë vitit. Të gjitha këto raporte bëhen publikisht të disponueshme nga Departamenti i Ndihmës Juridike.

¹ Mbetet për t’u koordinuar me nëngrupin e punës për profesionet e lira.

RELACION

PËR

PROJEKT-STRATEGJINË PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT (ELP)

I. Qëllimi i Strategjisë dhe objektivat që synohet të arrihen.

Strategjia për edukimin ligjor të publikut synon rritjen e ndërgjegjësimit ligjor publik në Shqipëri. Niveli i ulët i njohurive mbi ligjin përbën pengesë për zhvillimin njerëzor dhe ekonomik në Shqipëri. Me aderimin e Shqipërisë në BE, shoqëria shqiptare ka nevojë të përgatisë qytetarët që të jenë në gjendje të marrin pjesë aktivisht dhe efektivisht në një mjedis social dhe ekonomik të rregulluar ligjërisht.

Edukimi ligjor i publikut ka për qëllim: (i) të rrisë njohuritë mbi ligjin (ii) të promovojë **respektimin e ligjit**; (iii) të lehtësojë **marrëdhëniet e qytetarit me administratën**; (iv) të ulë numrin e **konflikteve ligjore**; dhe (v) të rrisë eksenin e qytetarëve në organet e drejtësisë dhe efikasitetin e **gjykatave dhe organeve publike**; duke shërbyer në forcimin e demokracisë.

II. Argumentimi i projektit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme

Institucionet zyrtare dhe organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri do të bashkëpunojnë në një rrjet me qytetarët, me qëllim që të forcojnë ndërgjegjësimin publik për ligjin, që të nxiten procedime ligjore të sigurta, pjesëmarrja qytetare në institucione, respektimi i ligjit, aksesin në drejtësi dhe kulturë të shtetit të së drejtës. Strategjia përcakton objektivat dhe përfitimet e edukimit ligjor të publikut (ELP), institucionet dhe organizatat së bashku me rolet dhe përgjegjësitë e tyre, formimin e një rrjeti për ELP, si dhe aktivitetet që duhet të përmbajë Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë.

Strategjia do të zbatohet nëpërmjet një rrjeti institucionesh dhe organizatash, roli i të cilave ka të bëjë me ndërgjegjësimin ligjor të publikut. Duke qenë se kapaciteti dhe përgjegjësitë për edukimin ligjor të publikut janë të shpërndara në mënyrë të gjerë dhe të pabarabartë, kjo është mënyrë efiçente dhe e zhdërvjelltë për të përfshirë pikat e shumta të përgjegjësisë, të cilat kanë rol në edukimin ligjor të publikut. Në qendër të rrjetit do të ketë organe koordinuese. Organet drejtuese të rrjetit do të jenë **Komisioni Drejtues** dhe **Bordi Këshillimor**. Komisioneri për të Drejtën e Informimit parashikohet të luajë një rol mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e strategjisë së edukimit ligjor të publikut nga organet publike, nëpërmjet nismave dhe aktiviteteve të ndryshme të programuara prej tyre paraprakisht. Do të ketë bashkëveprim edhe në kuadrin e zbatimit të ligjit “Për ndihmën ligjore”, sa u përket rregullimeve prej tij të ndihmës ligjore parësore.

Në emër të zbatueshmërisë së Strategjisë, grupi i punës propozon që në vijim të zbatimit të kësaj strategjie, të përmirësohen edhe disa ligje që do të përbëjnë bazën normative për një Strategji Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut, me një monitorim dhe koordinim sistematik. Legjislacioni që parashikohet të ndryshohet është si më poshtë:

(i) Ligji për të Drejtën e Informimit (ii) Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore (iii) Ligji për Avokatin e Popullit (iv) Ligji për Ndihmën Ligjore (v) Ligji për Arsimin Parauniversitar (vi) Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (vii) Ligji për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Konfliktëve (viii) Ligji për Organizimin e Gjyqësorit (ix) Ligji për Noterinë (x) Ligji për Profesionin e Avokatëve në Republikën e Shqipërisë, dhe (xi) Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa i takon ndryshimeve në fjalë përparësi ka ligji për “Të drejtën e Informimit” dhe ligji për “Ndihmën ligjore”.

III. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektit (sipas krerëve)

Projekti, parashikon krijimin e një rrjeti në qendër të të cilit do të ketë organe të thjeshta koordinuese. Grupi i punës nuk sheh nevojën që këto organe të punojnë me kohë të plotë dhe nuk propozohet të kërkohet financim publik për sekretariat të dedikuar. Rrjeti duhet të ndërtohet me një rregullim të butë ligjor. Ky mund të jetë një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet organizatave pjesëmarrëse. Organet drejtuese të rrjetit do të jenë *Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor*.

Komisioni Drejtues do të menaxhojë punën e Rrjetit. Komisioni do të jetë organ kolegjal dhe do të zgjedhë Kryetarin e tij. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Arsimit; Këshillit të Lartë Gjyqësor; Këshillit të Lartë të Prokurorisë; Kuvendit; Avokatit të Popullit; Universiteteve, organeve vendore dhe organizatave të Shoqërisë Civile. Këta përfaqësues do të shërbejnë edhe si pika kontakti për institucionet e tyre; prandaj ata duhet të kenë akses në nivelet më të larta vendimmarrëse brenda institucioneve të tyre për të siguruar njëhësim të punës në secilin institucion.

Bordi Këshillimor, do të përbëhet nga zyrtarë të lartë të të njëjtave institucione, bashkive, Dhomës së Avokatisë dhe Dhomës së Noterëve dhe do të ofrojë mbikëqyrje të politikave. Bordi do të mbledhet çdo tre muaj që të marrë raportin e Komisionit Drejtues, të miratojë planet dhe të japë udhëzime të përgjithshme për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë.

Projekti parashikon krijimin e lidhjes mes institucioneve dhe ekspertëve që kanë aftësinë të ofrojnë edukim ligjor, nga njëra anë, me institucione që kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetet për të informuar qytetarët apo organizata të shoqërisë civile, të cilat ofrojnë shërbime në lidhje me njohuritë ligjore, nga ana tjetër. Të gjithë këta anëtarë të rrjetit do të kenë lidhje elektronike me njëri-tjetrin. Rrjeti do të ketë një faqe në internet ku publikon punën e vet në mënyrë të përditësuar. Ai do të ketë një rezervë burimesh njerëzore dhe burimesh të tjera, profesionistë që ofrojnë shërbime vullnetare, burime ndërkombëtare, dokumente dhe mjete për rritjen e kapaciteteve dhe programimin. Për këtë qëllim dhe zbatimin e Strategjisë, fillimisht Grupi i Punës, Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor, pasi të konstituohen, do të kërkojnë angazhimin e institucioneve dhe do të punojnë me to për të evidentuar nevojat për rritjen e kapaciteteve dhe për të siguruar burimet e nevojshme njerëzore dhe të informacionit, me qëllim që të përmbushin përgjegjësitë për të cilat bien dakord.

Së treti, projekti parashikon ndryshimet ligjore për fuqizimin e mëtejshëm të ELP-së. Përveç ndryshimeve ligjore të rekomanduara nga grupi i punës, të cilat do të përbëjnë bazën normative për një Strategji Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut, projekti parashikon ndryshime edhe në *ligjet sektoriale*. Bordi Këshillimor dhe Komisioni Drejtues, në

bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën për Informim, nën mbikëqyrjen e forumeve të parashikuara në strategji, mund të realizojnë një rishikim të këtyre ligjeve.

IV. Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit

Secili institucion publik luan rol në edukimin dhe informimin e publikut. Iniciativat dhe masat për edukimin ligjor të publikut do të zbatohen në përputhje me Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut ("Strategjia") dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj.

Strategjia do të zbatohet nga institucione publike të përcaktuara me akt nënligjor (institucionet e përcaktuara) dhe subjekte jo shtetërore. Zbatimi i Strategjisë do të koordinohet nga një Komision Drejtues dhe një Bord Këshillimor, të përbërë nga përfaqësues të Institucioneve të Përcaktuara siç parashikohet në Strategji.

V. Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektit

Projekt Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut lindi si ide e nëngrupit të punës për Arsimin Juridik të Reformës në Drejtësi. Objektivi i punës së këtij nëngrupi ishte trajtimi i arsimit juridik në disa nivele të arsimit formal. Megjithatë gjatë diskutimeve të këtij grupi pune u gjykua e nevojshme që arsimi juridik të trajtohej edhe përtej këtij konceptit formal kupërveç institucioneve arsimore të përfshihen edhe organet shtetërore dhe shoqëria civile me qëllim zgjerimin dhe shtrirjen e edukimit ligjor edhe ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë, përtej arsimit formal. Pra përgatitja e strategjisë është kryer me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të nëngrupit të punës së arsimit juridik dhe edukimit ligjor të publikut të Reformës në Drejtësi, sa i takon përcaktimit të nevojës për një strategji të tillë dhe vlerësimin të draftit gjatë përgatitjes së tij. Ndërkohë, volumi më i madh i punës në kuadrin e hartimit të vetë Projekt Strategjisë është mbuluar nga ekspertët e nivelit të lartë të këtij nëngrupi e me kontribut të veçantë të bashkëkryetarit dhe këshilltar i lartë pranë OSBE-së, Z. Arthur Graham. Ekspertët e lartë janë asistuar edhe nga stafi teknik i nëngrupit. Gjithashtu, më 20 maj 2015, Projekt Strategjia është prezantuar edhe në një seancë konsultimi me grupe interesi, të cilët dhanë disa komente mbi rolin dhe funksionin e Strategjisë, komente të cilat më pas u reflektuan në draftin final të saj.

VI. Shpenzimet buxhetore që lidhen me miratimin e projektit

Gjatë hartimit të projekt Strategjisë nuk është ndërmarrë ndonjë vlerësim sa i takon implikimeve financiare të saj. Në gjendjen e tanishme të projekt aktit, potenciali i kostove financiare lidhet me operimin e dy organeve që themelon Strategjia, përkatësisht Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor. Ndërkohë që një vlerësim i mirëfilltë i pasojave financiare do të realizohet më mirë në momentin e propozimeve të ndryshimeve në legjislacion, sipas parashikimeve që bën vetë kjo Strategji. Me sugjerimin e amendamenteve përkatëse të ligjeve objekt ndryshimi, mund të kryhet një vlerësim financiar më i saktë në lidhje me kostot efektive që parashikon zbatimi i Strategjisë.

